



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.641/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z.Goran Milenković - Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, z.Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Studio Hapsira” shpk & “Taulant” shpk-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “PROing&Partners” Shpk- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Projekte për ndërtime të larta”, me nr. prokurimit: 616-19-4217-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, “Kuvendi Komunal Prishtinë”, më datë 23.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Studio Hapsira” shpk & “Taulant” shpk -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Projekte për ndërtime të larta”, me nr. prokurimit:616-19-4217-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “Kuvendi Komunal Prishtinë”.

II. VERTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Projekte për ndërtime të larta”, me nr. prokurimit:616-19-4217-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “Kuvendi Komunal Prishtinë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Studio Hapsira”shpk & “Taulant” shpk-Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:17.06.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 10.07.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt:10.07.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim me dt: 16.09.2019.

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesat për rishqyrtim me dt: 20.09.2019.

Operatori ekonomik ankues: “Studio Hapsira” shpk & “Taulant” shpk,-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP me dt: 30.09.2019, me nr.641/19, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Projekte për ndërtime të larta”, me nr. prokurimit: 616-19-4217-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “Kuvendi Komunal Prishtinë” duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin : 7, 10, 24, 27, 28, 40, 51, 56, 59, 60, 64, 67 dhe 69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.10.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit ,në raportin e dt: 14.10.2019, sqaron si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Studio Hapsira” Shpk &”Taulant”Shpk se AK gjatë fazës së vlerësimit të ofertave ka rekomanduar si fitues të mundshëm ofertën e cila nuk e përmbush kërkesën e përshtatshmërisë profesionale të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Kontrate, konkretisht tek Seksioni II, pika 9.1 dhe 9.2- kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme (ndërtim i lartë)në vlerë minimale prej 200,000.00 € në tri vitet e

fundit(duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontrate) dhe OE ankues pretendon se shumica e kontratave dhe referencave të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë "PROing&Partners"Shpk nuk kanë të bëjnë me kontrata dhe referenca për ndërtime të larta siç është kërkuar në Dosjen e tenderit, por kryesisht këto kontrata kanë të bëjnë me projekte infrastrukturore apo edhe projekte tjera por që nuk janë projekte për ndërtime të larta., eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

AK në Dosjen e tenderit tek Seksioni II, pika 9.1 dhe 9.2-kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme (ndërtim i lartë) në vlerë minimale prej 200,000.00 € në tri vitet e fundit duke dëshmuar me një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve. OE "PROing & Partners" Shpk i rekomanduar për kontratë se bashku me ofertën ka dorëzuar edhe një listë të kontratave të realizuara konform aneksit 6 të cilat po i analizojmë një nga një më poshtë:

1. Marrëveshje bashkëpunimi afarist në mes Kompanisë Zena Bauunternehmen dhe kompanisë "PROing & Partners" Shpk për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për ndërtimin e objektit banesor" ALB VILLA 2" e lidhur me datë 15/08/2018 në vlerë prej 70,000.00 €. Kjo kontratë ka të bashkëngjitur referencën e shërbimeve të realizuara por nuk ka të bashkëngjitur fletëpagesën e realizuar për shkak se kjo kontratë është e lidhur me kompani private.(Neni 69 i LPP-së dhe RRUOP Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale –Kur furnizimi është bërë për një blerës privat,për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë.

AK konform nenit 72 të LPP-se është dashur të kërkoj informacione shtesë për dëshmitë e realizimit të pagesave. "PROing & Partners"Shpk për hartimin e projekti ideor dhe kryesor për ndërtimin e objektit banesor" ALB VILLA 2" e lidhur me datë 15/08/2018 në vlerë prej 70,000.00 €.Kjo kontratë ka të bashkëngjitur referencën e shërbimeve të realizuara por nuk ka të bashkëngjitur fletëpagesën e realizuar për shkak se kjo kontratë është e lidhur me kompani private. (Neni 69 i LPP-së dhe RRUOP Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale –Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë. AK konform nenit 72 të LPP-se është dashur të kërkoj informacione shtesë për dëshmitë e realizimit të pagesave.

2. Marrëveshje bashkëpunimi afarist në mes Kompanisë Zena Bauunternehmen dhe kompanisë "PROing&Partners"Shpk për hartimin e projektit për ndërtimin e objektit banesor në vlerë prej 50,000.00€. Kjo kontratë ka të bashkëngjitur referencën e shërbimeve të realizuara por nuk ka të bashkëngjitur

fletëpagesën e realizuar për shkak se kjo kontratë është e lidhur me kompani private. AK konform nenit 72 të LPP-se është dashur të kërkoj informacione shtesë për dëshmitë e realizimit të pagesave.

3. Kontrata në mes OE "PROing & Partners" dhe KK Prizren për hartimin e projektit për renovimin dhe rekonstruimin e objektit të gjimnazit Gjon Buzuku me nr pro 622-18-052-221 e lidhur me 22.10.2018 në vlerë prej 7,800.00 € është konform kërkesave të dosjes së tenderit.(ka të bashkangjitur referencën e realizimit të shërbimeve).

4. Kontrata në mes OE "PROing & Partners" dhe KK Prizren për hartimin e projektit për ndërtimin e shtëpisë së pleqve me nr pro 622-16-119-236 e lidhur me 13.09.2016 në vlerë prej 1,210.00 € është konform kërkesave të dosjes së tenderit.(ka të bashkangjitur referencën e realizimit të shërbimeve).

5. Kontrata në mes OE "PROing&Partners" dhe QKUK për punimin e projektit kryesor për nënstacionin e gazrave medicinaleve për Ortopedi" me nr prok 701-17-157-236 e lidhur me 14.02.2018 në vlerë prej 1,770.00€, vetëm disa pozicione të kësaj kontrate kanë të bëjnë me ndërtim të lartë ndërsa pjesët tjera janë pajisje elektrike dhe pajisje mekanike.(është e bashkangjitur referenca e realizimeve të shërbimeve).

6. Kontrata në mes OE "PROing&Partners" dhe KK Rahovec për hartimin e projekteve të ndryshme me nr prok 623-19-158-2-2-1 e lidhur me 02.04.2019 në vlerë prej 120,000.00 € nuk ka përfunduar akoma Referenca e lëshuar nga KK Rahovec për vlerën e projekteve të realizuara deri më tani në vlerë prej 36,448.30€ nuk precizon se çfarë lloje të projekteve janë hartuar dhe kërkesa e dosjes së tenderit është për kontratat e realizuara.

7. Kontrata në mes OE "PROing&Partners" dhe KK Gjilan për hartimin e projekteve ideore dhe kryesore për nevojat e Komunës së Gjilanit me nr prok 651-18-2441-2-2-1 e lidhur me 13.05.2019 në vlerë prej 75,498.30€ nuk ka përfunduar akoma dhe nuk ka reference të realizimit të shërbimeve.

8. Kontrata në mes OE "PROing&Partners" dhe Këshillit Prokuroria të Kosovës për hartimin e projektit dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të punëve në objektin e Prokurorisë Speciale të Kosovës me nr prok 250-19-748-2-2-1 e lidhur me 16.05.2019 në vlerë prej 21,059.26 € nuk ka përfunduar akoma. Kjo kontratë ka pozicione të përziera ku për veq pozicioneve për ndërtime të larta ka edhe pozicionet e mbikëqyrjes së punimeve.

Mungon referenca e realizimit të projektit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

9. Kontrata në mes OE "PROing&Partners" dhe KK Obiliq për hartimin e projekteve detale me nr prok 614-18-2353-2-2-1 e lidhur me 08.06.2018 në vlerë prej 11,246.95 € ka pozicione të shumta ku për veq pozicionit të ndërtimeve të larta ka edhe lloje tjera të projekteve AK nuk ka kërkuar sqarime nga OE lidhur me pozicionet e kësaj kontratë referenca e lëshuar nga KK Obiliq përmban të gjitha pozicionet e kontratës dhe nuk dihet cila është shumta që i takon ndërtimeve të larta. Kontratat tjera të paraqitura nga OE "PROing&Partners" janë kryesisht kontrata për hartimin e projekteve të ujësjellsave ,kanalizimeve, hidrocentraleve etj që nuk përputhen me kërkesën e Dosjes së tenderit.

Konsiderojmë që kontratat dhe referencat e prezantuara nuk përmbushin kërkesën e Dosjes së tenderit për kontrata të realizuara (ndërtim i lartë) në vlerë prej 200,000.00 € në tri vitet e fundit.

Në vendimin e AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga OE “Studio Hapsira” Shpk & “Taulant” Shpk nuk ka arsyetuar se cilat kontrata apo pozicione të kontratave i ka vlerësuar në kalkulimin e vlerës prej 200,000.00 € (kontrata dhe referenca të realizuara për ndërtime të larta). Neni 108/A i LPP-së, pika 9 e obligon AK të ofroj arsyetime të detajuara për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të pranohet për arsyet që i theksuam në përgjigjeje të pretendimeve ankimore të më sipërme.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që ta kthej në RIVLERËSIM aktivitetin e prokurimit “Projektme për ndërtime të larta” me nr prokurimi 616-19-4217-2-2-1 të iniciuar nga AK-“KK Prishtina”

Operatori ekonomik përmes shkresës të datës 14.10.2019 është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit, mirëpo i njëjti nuk ka kthyer përgjigje.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 17.10.2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 23.10.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, ankues, përfaqësuesit AK-së, si dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Halimi deklaroi: AK (Autoriteti Kontraktues) ka shpërblyer me kontratë OE i cilin nuk e përmbush kërkesat e përshtatshmërisë profesionale të Dosjes tenderit dhe njoftimit për kontratë NENI 9.1&9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, (ndërtim i lartë) në vlerë minimale prej 200,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).

Më Datën 08.08.2019 kemi kërkuar qasje në dokumente zyrtare pranë AK Prishtinë, në dokumentet e prezantuara nga AK, pas analizimit dhe krahasimin e dokumenteve konstatohet OE Proing Partners nuk i plotëson kriteret e përshtatshmërisë profesionale të njoftimi për kontratë dhe dosje tenderit , nuk ka dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme të precizuar (Ndërtime të Larta) me vlerë prej 200,000.00€ të bashkangjitur me Referencë apo raport të pranimit.

Dispozita Ligjore të shkelura :

NENI 7 : Barazia në trajtim / jo-diskriminimi.

NENI 10 : Mjetet për promovimin e transparencë.

NENI 24 : Zyrtaret e prokurimit gjatë ushtrimit të aktivitetëve të prokurimit.

NENI 27 : Dosja e tenderit.

NENI 28 : Llojet e specifikimeve teknike.

NENI 40 : Njoftimi i kontratës.

NENI 51 : Njoftimi i kriterëve të dhënies kontratës.

NENI 56 : Dispozita e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave .

NENI 59 : Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

NENI 60 : Kriteret për dhënien e kontratës .

NENI 64 : Dëshmi Kërkesa.

NENI 67 : Provat shkresore .

NENI 69 : Aftësia teknike dhe /ose profesionale.

Provat e paraqitura në seancë :

1.							
1.	"Hartimi i projektit per ndërtimin e objektit banesor ALB VILLA 2" Neubau von Zwei Mehrfamilien – Wohnhäuser mit Tiefgarage, Hauptstrasse 19+28 / D -78549 Spaichingen.	15.08.2018	10.12.2018	70,000.00 €	ZENA BAUUN TERNEH MEN	albvilla1@ gmail.com	+49(0) 172- 6351384 +49(0) 741- 2706507

Kjo kontratë është private jo publike

2.							
2.	"Hartimi i projektit për ndërtimin e objektit banesor " B.V. Neubau eines Mehrfamilienwohnhauses mit Sieben Wohneinheiten und Tiefgarage mit Stellpatzen und 3 Außenparkplätzen. Turtlinger str. 9/4 78628 Rottweil.	30.11.2018	07.01.2019	50,000.00 €	ZENA BAUUN TERNEH MEN	albvilla1@gmail.com	+49(0) 172-6351384 +49(0) 741-2706507

Kjo kontratë është private jo publike- Vazhdimësi e kontratës së parë.

Bazuar në interpretimin e KRPP për kontrata private , dhe NENI 72 të LPP-së duhet dëshmohen përmes transaksionet bankare, nëse nuk dëshmohet transaksionet bankare kjo kontratë nuk merret valide. Ne nuk kemi hasur në dëshmi që OE i posedon transaksionet bankare për këtë projekt.

12.	Hartimi i projekteve për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve publike	06.07.2015	06.07.2016	46,113.30 €	K.K. PRIZRE N	isa.osmank aj@arks- gov.net	0382004470 4
-----	---	------------	------------	----------------	---------------------	-----------------------------------	-----------------

Kjo kontratë nuk i takon kategorisë së ndërtimeve të larta – nuk e përmbush kërkesë e përshtatshmërisë profesionale të dosjes tenderit dhe njoftimit kontratë.

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, (ndërtim i lartë) në vlerë minimale prej 200,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).

PROVË MATERIALE : REFRENCA E LËSHUAR NGA KOMUNA PRIZRENIT

REFERENCE

Për projektin:
"Hartimi i projekteve për nevojat e DSHP në Komunën e Prizrenit"

Projektuesi:
N.P.N "PROing" nga Prishtina

Hyrja e projektares N.P.N "PROing" nga Prishtina është kontraktuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit Drejtoria për Shërbime Publike që të bëjë hartimin e projekteve për nevojat e saj.

Duke u bazuar në detyrën projektuese sipas kontratës me nr.622-15-89-221, Byroja në fjalë është obliguar që të hartoj projektet të cilat janë enklavuar nga Drejtoria për ndërtimin e rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse dhe atë:

1. Projektet e rrugëve;
2. Kanalizimi i ujërave të zeza-KUZ;
3. Kanalizimi i ujërave të bardha(atmosferik)-KUB;
4. Rrjetet e ujësjellësit;
5. Shënjestrimet horizontale dhe vertikale;
6. Ura nga betoni me gjatësi L=6-12;
7. Mure mbrojtëse me lartësi deri në 8 m;
8. Rregullimi i hapësirave gjelbra, porqet etj.

Nga byroja projektuese janë hartuar projektet në fjalë sipas detyrës projektuese në afat të parapërdëktuar dhe duke i zbatuar rregulloren dhe standardet teknike.

Vlera e projekteve të realizuara është 46.113.30 €.

Jeni të bindur se N.P.N "PROing" nga Prishtina është e aftë dhe e kualifikuar për hartimin e projekteve të rrugëve me infrastrukturës përcjellëse dhe në 1 përfundim të gjitha organizatat dhe institucionet tjera të cilat kanë nevojë për bashkëpunim në lëmin e projektimit.

Organi mbikqytës

1. Hatixhe Perzhehija, ing.dip.injert

2. Ejup Kryeziu, ing.dip.injert

Në referencë dëshmohet se në këtë kontratë nuk e ka projektuar asnjë kontratë të ngjashme për ndërtime të larta, shumë qartë është e specifikuar që OE ka projektuar : Projekte të rrugëve , kanalizimeve ,rrjet ujësjellësit , shënjestrim horizontal , ura , mure mbrojtëse , rregullim hapësirave.

Kjo kontratë nuk është dashur të merret parasysh nga AK.

Nuk ka dhënë shpjegime apo arsyetim se cilat nga elemente përbërë të kësaj kontrate në paramasën dhe parallogaritë plotëson kriterin e përshtatshmërisë profesionale , duke precizuar pozicionin dhe vlerën e atij pozicioni e cila duhet të merret parasysh si kontratë e ngjashme (Ndërtime të larta). Pasi në është kontratë shumica e pozicioneve janë infrastrukturë dhe nuk i plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale të njoftimi për kontratë dhe dosje tenderi , vlera e kontratë nuk mund të merret e tërësishme po vetëm ajo vlerë e cila plotëson kriteret e përshtatshmërisë profesionale.

7.	Hartimi i projektit ideor dhe kryesor të HidroElektroCentralit Prizren 5.	22.09.2017	20.11.2017	15,000.00 €	"Prizren 5 Energy" Sh.p.k	kujtimhoxha@gmail.com	044 502 744
8.	Hartimi i projektit ideor dhe kryesor të HidroElektroCentralit Lloqan.	17.11.2017	17.04.2018	50,000.00 €	"Lloqan Energy" Sh.p.k	kujtimhoxha@gmail.com	044 502 744

Kjo Refrencë është në kundërshtim me Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, pasi nuk është referencë e ngjashme , nuk i takon kategorisë së ndërtimeve të larta , dhe në paramasën e këtij aktivitetit prokurimi në pozicionet e listuara nuk ka hartim projekteve për ndërtim hidrocentraleve (Hidrocentraleve i takojnë kategorisë së objekteve hidroekonomike jo ndërtime të larta

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndertim i lartë) ne vlere minimale prej 200,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).

10	Hartimi i projekteve ideore dhe Kryesore per nevojat e komunes se Gijilanit LOT 1 Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore per objekte te ndertimit te larte.	13.05.2019	13.05.2022	75,498.30 €	K.K Gijilan	prokurimigijilan@rks-gov.net	0280 321 217
----	---	------------	------------	-------------	-------------	------------------------------	--------------

MUNGON REREFENCA DHE RAPORTI I PUNËS SË KËSAJ KONTRATE DUKE MARRË PARASYSH QË KJO KONTRATË ËSHTË KORNIZË 36 MUAJË E NËNSHKRUAR ME DATËN 15.05.2019 KA VALIDITET , AK DUHET TA SQAROJË SE QFARE VLERE KA ARRITUR KONTRATA DERI ME DATËN E HAPJES TË DËSHMUAR ME REFERNCË APO RAPORT PRANIMIT PUNËVE.

P.S Gjatë qasjes së dokumenteve zyrtare në këtë aktivitet prokurimit i ka munguar referenca dhe raporti i punës.

11.	Hartimi i projektit dhe mbikqyrja e ekzekutimit te punimeve per objektin e prokurorise Specilac te Kosoves	16.05.2019	Projekti 30 ditë Kalendarik e Mbikqyrja 36 Muaj	21,056.26 €	Këshilli Prokurorior i Kosovës	Flora.doda@rks-psh.org	038-200-18-705
-----	--	------------	---	-------------	--------------------------------	------------------------	----------------

Nuk mund të merret për bazë vlera e tërësishme e kontratës , pasi në këtë kontratë përveç projektimit është përfshirë edhe mbikëqyrja e objektit , pozicioni i mbikëqyrjes me vlerë 5659.26 euro nuk i takon kategorisë të projekteve të ngjashme të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike të dosjes tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Në aktivitetin e prokurimit të iniciuar nga AK në paramasë dhe parallogari nuk ka pozicione të mbikëqyrjes po vetëm të projektimit , në këtë rast AK nuk është dashur ta merr për bazë.

MUNGON REREFENCA E KËTIJ AKTIVITETI PROKURIMIT

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇNIMEVE

1 Mbikqyrja profesionale inzhinierike e projektit per renovimin e objektit te Prokurorise Speciale te Kosoves					
Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia (Euro vlera investive)	Çmimi për njësi DDP % / Njesi	Shtesa €
0	1	2	3	4	5 = 3 x 4
1.1	Mbikqyrja profesionale inzhinierike në të gjitha fazat e ndërtimit dhe realizimit teknik dhe përbashkëpunim përfaqësues	%	1,280,195.00	0.44%	5,659.26
TOTALI 1					5,659.26

2 Hartimi i projektit per renovimin e objektit te Prokurorise Speciale te Kosoves					
Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi për njësi DDP € / Njesi	Shtesa €
0	1	2	3	4	5 = 3 x 4
2	Hartimi i projektit ideor, kryesor dhe i renovimit - patir - duke përfshirë edhe furnizimin e gjenies ne bërthmë.				
2.1	Incident i gjenies epradues se detajuar, bazat, terret dhe dorat e objekti, foto te gjenies epradues	m ²	4000	0.80	3,200.00
2.2	Përshkrimi teknik, paratise dhe parallogari per fazat e projektimit, Ujesjellës, kanalizim, elektrik, makineri, sistomi solat, ventimi dhe klimatizimi	m ²	4000	0.80	3,200.00
2.3	Projekti - Fazat e arkitektures se detajuar, komplet paratit e përbashkë dhe paratit - gjenies e renovimit	m ²	4000	1.00	4,000.00
2.4	Projekti - Fazat e Elektrikes se brendshme, shpërnderjes, LAN, IT, TV, DMB, video monitorim, interfori, ndihjetit i pajtimit, kyqes e gjeniesit epradues	m ²	4000	0.20	800.00
2.5	Projekti - Fazat e makinerise, ngjorje qendore, sistem solar si dhe klimatizim dhe ventim, se bashku me nyjet, sanitom, instalimet, etj	m ²	4000	0.20	800.00
2.6	Elaportim kunder qarit per fazat objekti, te bashku me te gjitha agjentit per instalim dhe mëtërmbajtje	m ²	4000	0.20	800.00
2.7	Projekti - Fazat e Ujesjellës dhe kanalizimit, duke e marrë për bazë edhe qin e ngjorjes sanitar, nyjet, sanitom, instalimet, etj	m ²	4000	0.15	600.00
2.8	Elaborimi i faksit se ndërtimit dhe aplikimi i masave për efiziençë te energjike	m ²	4000	0.10	400.00
2.9	Punimi i projektit ideor - PËRQULUM I PARTITIVET	m ²	4000	0.40	1,600.00
TOTALI 2					15,400.00
Rekapitullim					çmimi total
Mbikqyrja profesionale inzhinierike e projektit per renovimin e objektit te Prokurorise Speciale te Kosoves (Totali 1)					5,659.26
Hartimi i projektit per renovimin e objektit te Prokurorise Speciale te Kosoves (Totali 2)					15,400.00
Projekti ideor (Totali 2.1)					
Projekti kryesor (Totali 2.2)					
Projekti i renovimit (Totali 2.3)					
TOTALI ME TE GJITHA TAKSAT					21,059.26

13	Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore per: objekte te infrastrukturës rugore, trotuare, ujësjellës, kanalizim, sinjalizim horizontal dhe vertikal.	15.05.2014	15.05.2016	50,000.00 €	K.K. Kamenice	prokurimi.kamenice@rks-gov.net	03820047646
----	---	------------	------------	-------------	---------------	--------------------------------	-------------

Kjo kontratë nuk i takon kategorisë së ndërtimeve të larta – nuk e përmbush kërkesë e përshtatshmërisë profesionale të dosjes tenderit dhe njoftimit për kontratë.

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, (ndërtim i lartë) në vlerë minimale prej 200,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).

Nuk ka dhënë shpjegime apo arsyetim se cilat nga elemente përbërëse të kësaj kontrate në paramasen dhe parallogarin plotëson kriterin e përshtatshmërisë profesionale , duke precizuar pozicionin dhe vlerën e atij pozicioni e cila duhet të merret parasysh si kontratë e ngjashme (Ndërtime të larta). Pasi në është kontratë shumica e pozicioneve janë infrastrukturë dhe nuk i plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale të njoftimi për kontratë dhe dosje tenderi , vlera e kontratë nuk mund të merret e tërësishme po vetëm ajo vlerë e cila plotëson kriteret e përshtatshmërisë profesionale.

MUNGON PARAMASA DHE PARALLOGARIA E KËSAJ KONTRATE ,AK TË SQAROJ SE CILAT POZICIONE TË KËSAJ KONTRATE PLOTËSOJNË KRITERET E PËRSHTATSHËRISE PROFESIONALE SA ËSHTË VLERA E TYRE NUK KA TRANSPARENCË NË KËTË KONTRATË.

4	Hartimi i projekteve detale	08.06.2018	12.02.2019	11,246.95 €	K.K Obiliq	leonarda.c mini@aks- gov.net	+383 45 846 063
---	--------------------------------	------------	------------	----------------	---------------	------------------------------------	--------------------

Kjo kontratë nuk i takon kategorisë së ndërtimeve të larta – nuk e përmbush kërkesë e përshtatshmërisë profesionale të dosjes tenderit dhe njoftimit për kontratë.

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, (ndërtim i lartë) në vlerë minimale prej 200,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).

Nuk ka dhënë shpjegime apo arsyetim se cilat nga elemente përbërëse të kësaj kontrate në paramasen dhe parallogarit plotëson kriterin e përshtatshmërisë profesionale , duke precizuar pozicionin dhe vlerën e atij pozicioni e cila duhet të merret parasysh si kontratë e ngjashme (Ndërtime të larta). Pasi në është kontratë shumica e pozicioneve janë infrastrukturë dhe nuk i plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale të njoftimi për kontratë dhe dosje tenderi , vlera e kontratë nuk mund të merret e tërësishme po vetëm ajo vlerë e cila plotëson kriteret e përshtatshmërisë profesionale.

PËRFUNDIM :

AK (Autoriteti Kontraktues) ka shpërblyer me kontratë OE i cilin nuk e përmbush kërkesat e përshtatshmërisë profesionale të Dosjes tenderit dhe njoftimit për kontratë NENI 9.1&9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, (ndërtim i lartë) në vlerë minimale prej 200,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj.Jashari deklaroj: Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me mendimin e Eksperti Shqyrtues sepse kërkesë e Autoriteti Kontraktues tek kapacitetet teknike dhe profesionale ka qenë që tenderuesi duhet të dorëzojë një listë të kontratës, ANEKSI 6, Listës të bashkohen referencat ose Certifikatat për kryerjen e punëve, ku nga kjo rrjedhë se Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar dëshmi të tjera por vetëm dëshmi për kontratat dhe referencat e realizuara. OE i propozuar për kontratë ka dorëzuar ANEKSIN e plotësuar me të gjitha të dhënat dhe nga aty janë pranuar referencat e ngjashme si në vijim:

1. Hartimi i projektit për kompleksin Banesor 70.000 euro

1. Hartimi për projektin Banesor BV-NEË BAU në vlerë 50.000 euro

2. Hartimi i projektit për restaurim në vlerë 7.800 euro

3. Punimi i projekteve për nënstacionin e gazrave medicinale për ortopedi 1.770 euro

4. Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore të Hidrocentraleve Prizren 15.000 euro

5. Hartimi i projekteve ideor dhe kryesor të Hidro centralit Lloqan vlera 50.000 euro

Vlera totale është 207.069.25 euro

6. Hartimi i projekteve Detale 11.249.95 euro

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Papaj deklaroj: Mbes prapa ekspertizës sime. Tek pika 9.1 dhe 9.2 është kërkuar që OE të paraqes kontratë të ngjashme në vlerë prej 200.000 euro. OE i rekomanduar ka ofruar një listë të gjere të kontratave, Kontrata e pare me Vila ALFA në vlerë prej 120.000 euro me OE privat, pjesa tjetër janë kontratë të ndryshme, Autoriteti Kontraktues është dashtë që të liston Listën e kontratave.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Halimi deklaroj: Duke u bazuar në argumentet e specifikuar më lartë kërkojmë nga OSHP të bëjë anulimin për dhënie Kontratës, e njëjta ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe të marrë si të bazuar kërkesën tonë për ri-shqyrtim të lëndës , pasi konsiderojmë që AK gjatë këtij aktiviteti të prokurimit në masë substanciale nuk e ka respektuar LPP

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj.Jashari deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të hedhë poshtë ankesën e OE si të pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Pretendim i OE ankues “Studio Hapsira” Shpk & “Taulant” Shpk ëshët se autoriteti kontraktues gjatë fazës së vlerësimit të ofertave ka rekomanduar si fitues të mundshëm ofertën e cila nuk e përmbush kërkesën e AK-së tek Seksioni II, pika 9.1 dhe 9.2- kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme (ndërtim i lartë) në vlerë minimale prej 200,000.00 €, në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë) dhe OE ankues pretendon se shumica e kontratave dhe referencave të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë “PROing & Partners” Shpk-Prishtinë, nuk kane të bëjnë me kontrata dhe referenca për ndërtime të larta siç është kërkuar në Dosjen e tenderit, por kryesisht këto kontrata kanë të bëjnë me projekte infrastrukturore apo edhe projekte tjera por qe nuk janë projekte për ndërtime të larta.

Lidhur me këtë pretendim të OE ankues, paneli shqyrtues fillimisht konstaton se kërkesa e AK-së në lidhje me kontratat është paksa konfuze sepse fillimisht është e shënuar se kërkohen kontrata të ngjashme ndërsa pas kësaj fjalie është futur në kllapa fjala ndërtim i lartë, prandaj janë përdorur dy terme që mund të kuptohen në dy aspekte, ndërsa në këto raste autoritetet kontraktuese duhet të përdorin standard të njëjtë dhe duhet ti trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë ofertuesit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se OE i rekomanduar për kontratë “PROing & Partners” Shpk-Prishtinë, se bashku me ofertën ka dorëzuar edhe një listë të kontratave të realizuara konform aneksit 6.

Paneli shqyrtues sqaron se pretendimi OE ankues ka qenë që dy kontratat në vijim:

Marrëveshje bashkëpunimi afarist në mes Kompanisë Zena Bauunternehmen dhe kompanisë “PROing& Partners” Shpk, për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për ndërtimin e objektit banesor “ALB VILLA 2” e lidhur me datë 15/08/2018, në vlerë prej 70,000.00 € dhe tjetra për hartimin e projekti ideor dhe kryesor për ndërtimin e objektit banesor “ALB VILLA 2” e lidhur me datë 30/11/2018, në vlerë prej 50,000.00 €, kanë të bashkangjitur referencën e shërbimeve të realizuara por nuk kanë të bashkangjitur fletëpagesën e realizuar për shkak se këto kontrata janë lidhur me kompani private.

Sa i përket pretendimit të lartpërmendur të OE ankues se për këto dy kontrata që ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë me institucione apo kompani private, nuk ka ofruar transaksione bankare, në lidhje me këto kontrata, paneli shqyrtues sqaron se transaksionet bankare nuk kanë qenë kërkesë e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj sipas nenit 56.3 të LPP-së *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*. Prandaj duke u bazuar në këtë dispozitë të LPP-së

autoritetet kontraktues nuk mund të eliminojnë operatorët ekonomik për kërkesa që nuk janë parashikuar në dosje të tenderit.

Duke marr parasysh këto dy kontrata si dhe kontratat dhe dëshmitë tjera që ka pasur të bashkangjitura me dosje të tenderit OE i rekomanduar për kontratë si dhe duke pasur parasysh edhe sqarimet detale të AK-së, paneli shqyrtues vjen në përfundim se OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesën e AK-së në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional, sa i përket vlerës së kontratave të kërkuara, prandaj edhe pretendimi i OE ankues është i paqëndrueshëm në lidhje me këtë çështje.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht konstaton se të gjithë operatorët ekonomik janë trajtuar në mënyrë të barabartë sipas nenit 7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar konform këtij neni. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka marr parasysh dhe ka vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK -"Kuvendi Komunal"- Prishtinë

1x1 OE -"Studio Hapsira"shpk & Taulant shpk

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran MILENKOVIC

